



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRISHTINE - DEGA E GJYKATËS PODUJEVË

Numri i lëndës: 2025:027873

Datë: 10.03.2025

Numri i dokumentit: 06963781

NË EMËR TË POPULLIT

P.nr. 50/25

GJYKATA THEMELORE PRISHTINË - DEGA PODUJEVË - Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Penal, Gjyqtari i vetëm gjykues Minir Hoti, me sekretaren juridike Fatmire Podvorica si procesmbajtëse dhe bashkëpunëtorit profesional Muhamet Musliu në çështjen penale kundër të pandehurit N. H. për shkak të veprës penale Vjedhje pylli nga neni 349 par.2 të KPRK-së, sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore Prishtinë - Departamenti i Përgjithshëm, PP.II.nr.3288/2024, të datës 11.02.2025, në seancën e shqyrtimit fillestar publik të mbajtur me datë 10.03.2025, në të cilin ishin të pranishëm Prokurori i Shtetit Dardan Çela dhe i pandehuri, në të njëjtën ditë mori publikisht, shpalli dhe përpiloi këtë:

A K T G J Y K I M

I pandehuri,

N. H., nga i ati I. e ëma S., e gjinisë I., i lindur më ..., me vendbanim në fshatin B., K-P., i martuar baba i tre fëmijëve, ka të kryer shkollën fillore, i gjendjes së dobët ekonomike, me numër personal të letërnjoftimit ... , shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës.

Ë S H T Ë F A J T O R

Me datë 01.04.2024 rreth orës 16:47, në vendin quajtur "M.", Rajoni T., njësia menaxhuese M.-B., KK-P., i pandehuri N. H., me qëllim që me përvetësimin e sendeve të huaja të luajtshme vetit t'i sjell përfitim pasuror të kundërligjshëm, është takuar duke prerë dru me motosharrë, pa leje paraprake nga organi kompetent, dhe atë 43 copë trungje, me gjatësi rreth 9m me diametër 20-30cm vëllimi i përgjithshëm 4.22m³, me ç' rast, të dëmtuarës Drejtorisë e Inspeksionit – Sektorit i Pyltarisë të Komunës së P. i ka shkaktuar dëm në vlerë prej 569.70 €,-

-me këtë ka kryer veprën penale Vjedhje pylli nga neni 349 par. 2, të KPRK-së

Andaj, gjykata në bazë të dispozitave ligjore të neneve 4, 7, 8, 9, 10, 17, 21, 38, 39, 40, 43, 46, 47, 48, 49, 59, 61, 69, 70 dhe nenit 349 të KPRK-së, si dhe në bazë të neneve 364, 365, 368, 369, 449 dhe 452 të KPPRK-së, e:

G J Y K O N

I. Me dënim me gjobë në shumë prej **300.00 (treqind) euro** i cili dënim do të ekzekutohet në afatin prej 15 ditësh nga dita kur aktgjykimi të merr formën e prerë, si dhe **dënim me burgim të kushtëzuar** në kohëzgjatje prej 3 (tre) muaj i cili dënim nuk do të ekzekutohet nëse i pandehuri brenda periudhës verifikuese prej një viti nuk kryen veprë tjetër penale.

II .Në rast se i pandehuri nuk e paguan dënimin me gjobë brenda afatit të përshkruar më lartë, atëherë dënimi me gjobë do t 'i zëvendësohet me dënim me burgim, ashtu që për çdo 20,00 € të dënimit me gjobë do t 'u caktohet 1 (një) ditë burgim.

III . Detyrohet i akuzuari që në emër të shpenzimeve të procedurës penale, për paushallin gjyqësor të paguaj shumën prej 20€ (njëzet/euro), ndërsa në emër të taksës për kompensimin e viktimave të paguaj shumën prej 20€ (njëzet/euro), në afat prej 15 ditësh pasi aktgjykimi të merr formën e prerë.

Konform neni 59 par. 1 pika 2.2 të pandehurit i shqiptohet:

DËNIM PLOTËSUES

Me të cilin urdhërohet i pandehuri N. H., që të dëmtuarës Drejtorisë e Inspeksionit – Sektorit i Pylltarisë të Komunës së P. t 'ia kompensoj dëmin në vlerë prej 569.70€.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore Prishtinë-Departamenti i përgjithshëm, ka ushtruar aktakuzën PP.II.nr.3288/2024, të datës 11.02.2025, kundër të akuzuarit N. H. për shkak të veprës penale Vjedhje pylli nga neni 349 par.2 të KPRK-së.

Lidhur me këtë çështje penale gjykata caktoi dhe mbajti seancën e shqyrtimit fillestar më datë 10.03.2025, gjatë të cilës prezantuan Prokurori i Shtetit Dardan Çela nga Prokuroria Themelore në Prishtinë dhe i pandehuri.

I pandehuri pas leximit të aktakuzës nga prokurori i shtetit deklaroi: Se e pranojë fajësinë, ,i premtoj gjykatës se më nuk do të ndodhë, jam i pa punësuar dhe pa kurrfarë të ardhurash, e lus gjykatën për një dënim sa më të lehtë.

Prokurori i Shtetit Dardan Çela lidhur me pranimin e fajësisë nga i pandehuri deklaroi: Pajtohem me pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurit, sepse i njëjti është bërë me vullnetin e plotë nga i pandehuri dhe bazuar ne shkresat e lëndës. Me rastin e përcaktimit të llojit dhe lartësisë së dënimit gjykata të merr për bazë rrethanat lehtësuese dhe ato rënduese. Si rrethanë rënduese gjykata të marr shkallën e lartë të dashjes nga i pandehuri për të kryer veprë penale, pastaj intensitetin e rrezikimit apo vlerës së mbrojtur kur kihet parasysh fakti se që janë shkaktuar dëme natyrore e cila gëzon mbrojtje të veçantë me ligj, përgjegjësia e tij në lidhje me veprën

penale, ndërsa si rrethanë lehtësuese gjykata të marr pranimin e fajësisë. Gjykatës i propozojmë që t'i shqiptoj edhe dënimin plotësues urdhrin e kompensimit të dëmit siç parashihet me nenin 59 dhe 61 të KPRK-së, e po ashtu i njëjti të obligohet të i paguaj shpenzimet e procedurës penale.

Gjyqtari i vetëm gjykues konstaton se i pandehuri e ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimit të fajësisë, pranimi i fajësisë u bë vullnetarisht nga i pandehuri, pranimi i fajësisë mbështetet në faktet e çështjes që i përmban Aktakuza, në materialet e prezantuara nga Prokurori i Shtetit, dhe aktakuza nuk përmban asnjë shkelje ligjore apo gabime faktike.

Gjykata pas pranimit të fajësisë nga i akuzuari, si dhe marrjes së mendimit të palëve, respektivisht prokurorit të shtetit, si dhe provave që gjenden në shkresat e lëndës vërteton se janë përmbushur të gjitha kushtet ligjore të parapara sipas dispozitës së nenit 242 par.2 të KPPRK-së, dhe e aprovoi pranimin e fajësisë nga ana e të akuzuarit në shqyrtimin fillestar, andaj gjykata konform nenit 242 par.6 të KPPRK-së, ka vazhduar me shqiptimin e dënimit.

Gjatë procedurës penale nuk janë paraqitur rrethana të cilat do ta përjashtojnë përgjegjësinë penale të akuzuarit, kështu që i njëjti është penalisht përgjegjës.

Në bazë të gjendjes faktike të vërtetuar nga vet i akuzuari, gjykata vlerëson se në veprimet inkriminuese të akuzuarit përmbushën të gjitha elementet qenësore të veprës penale vjedhja e pyllit nga neni 349 par.2 të KPRK-së, për çka gjykata gjeti se i akuzuari në aspektin penal-juridik është përgjegjës dhe të njëjtin e shpalli fajtor, andaj i shqiptoi dënim si në dispozitiv të aktgjykimit.

Me rastin e vendosjes së llojit dhe lartësisë së dënimit, gjykata pati parasysh të gjitha rrethanat e parapara me nenin 69 dhe 70 të KPRK-së dhe në rastin konkret si rrethana lehtësuese gjeti faktin se i akuzuari në shqyrtimin fillestar e ka pranuar në tërësi fajësinë për veprën penale e cila i vihet në barrë, jeton në kushte të rënda ekonomike, premtan se më nuk do të kryej veprime të tilla, ndërsa si rrethana rënduese gjykata nuk gjeti. Andaj gjykata ka ardhur në përfundim se dënimi i shqiptuar të akuzuarit si në dispozitiv të këtij aktgjykimi është në përputhje me peshën e veprës penale, shkallën e përgjegjësisë penale të tij dhe me intensitetin e rrezikimit të vlerave të mbrojtura, rrethanat në të cilat është kryer vepra penale, gjykata gjithashtu është e bindur se vendimi mbi dënim do të shërbej për arritjen e qëllimit të dënimit në parandalimin e të akuzuarit nga kryerja e veprave penale në të ardhmen dhe të bëjë rehabilitimin e tij por ai duhet të ndikoj edhe si preventivë e përgjithshme për personat tjerë që t'i parandaloj nga kryerja e këtyre veprave penale dhe të shpreh gjykim shoqëror për veprën penale, ngritjen e moralit dhe forcimin e detyrimit për respektimin e ligjit, të gjitha këto të parapara me nenin 38 të KPRK-së.

Vendimi mbi mundësinë e zëvendësimit me gjobë në dënim me burgim është marrë në kuptim të nenit 43 të KPRK-së.

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës penale dhe paushallit gjyqësor është marrë në bazë të nenit 449 par.2 nën par. 2.6 të KPP-së, ndërsa vendimi për kompensimin e viktimave të krimit është marr konform nenit 36 par. 3 nën-par. 3.1 të Ligjit nr. 08/L-109.

Vendimi mbi shqiptimin e dënimit plotësues me të cilin detyrohet i pandehuri që të ia kompensoj dëmin të dëmtuarës, gjykata e ka marr konform nenit 59 par. 1 pika 2.2 dhe 61 par. 1 të KPRK-së.

Nga sa u tha më lartë e në bazë të nenit 364 të KPRK-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE PRISHTINË-DEGA PODUJEVË
Departamenti i Përgjithshëm-Divizioni Penal
P.nr.50/25 me dt.10.03.2025.

Sekretare juridike
Fatmire Podvorica

Gjyqtari i vetëm gjykues
Minir Hoti

KËSHILLË JURIDIKE:

Kundër këtij aktgjykimi mund të ushtrohet ankesë në afat prej 30 ditësh nga dita e pranimi të njëjtit, Gjykatës së Apelit në Prishtinë nëpërmes kësaj Gjykate.